



**DRAFT STRATEGJIA PËR ARSIMIN LOKAL
PËR
KOMUNËN E TEARCËS
2007 - 2014**

E përgatitur nga
Departamenti për arsim
Muamet Rexhepi
Komuna e Tearcës

PËRMBAJTJA E STRATEGJISË LOKALE PËR ARSIM

1. HYRJE
2. KORRNIZA LIGJORE PËR DECENTRALIZIMIN E ARSIMIT NË KOMUNËN E TEARCË
3. METODOLOGJIA PËR FORMULIMIN E STRATEGJISË PËR ARSIM LOKAL NË KOMUNËN E TEARCËS
 - 3.1 Informata të përgjithshme
4. SITUATA E ARSIMIT NË TEARCË
 - 4.1 Numri i shkollave dhe gjendja
 - 4.2 Rrjeti shkollor dhe karakteristikat e mësimdhënësve
 - 4.2.1 Rrjeti shkollor
 - 4.2.2 Karakteristikat e mësimdhënësve
 - 4.3 Buxheti për arsim
 - 4.4 Transporti dhe ngrohja
 - 4.4.1 Transporti i nxënësve
 - 4.4.2 Ngrohja
- 5 SWOT ANALIZA
- 6 QËLLIMI STRATEGJIK DHE PIKËSYNIMET STRATEGJIKE
 - 6.1 Pikësynimet operacionale, Aktivitetet dhe Buxheti

1. HYRJE

Kompetencat e reja në fushën e arsimit në Republikën e Maqedonisë, të cilat u transferuan prej nivelit qendror në nivel të komunave, duhet të trajtohen nga ana e vetqeverisjes lokale në mënyrë strategjike. Kjo do të sigurojë efikasitet optimal dhe menaxhim të suksesshëm të arsimit fillor dhe të mesëm të cilët janë me rëndësi të madhe për bashkësinë lokale.

Kompetencat e reja në arsim kërkojnë reforma nga sistemi i vjetër i menaxhimit me shkollat dhe krijimin e strategjisë lokale për arsim për përmirësimin e menaxhimit dhe kualitetit të arsimit në vitet e ardhëshme. Prandaj është me rëndësi të madhe për pushtetin lokal të krijojë plan i cili do t'i kombinojë (integrojë) pikësynimet më të rëndësishme afatgjate të njësisë së pushtetit lokal, politikatat edhe programet e tija të cilat do të jenë koherente. Me këtë plan strategjik pushteti lokal do të ketë një fotografi të qartë të situatës në sektorin e arsimit dhe to t'i ndërmerr orvajtjet e vërteta për përmirësimin e kualitetit të mësimdhënies, përmirësimin e kualitetit e pajisjeve shkollore dhe përmirësimin e objekteve shkollore.

2. KORRNIZA LIGJORE PËR ARSIMIN NË TEARCË

Njëra prej risive në sistemin juridik dhe politik të Republikës së Maqedonisë është decentralizimi i përforcuar dhe bartja e një numri të madh të kompetencave prej pushtetit qendror në atë lokal. Pikë kyçe në Marrëveshjen Kornizë e cila u nënshkrua në vitin 2001 në Ohër, ishte pikërisht **Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar**¹ e paraqitur në amandamentin XVII të kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Si konfirmim i këtyre ndryshimeve në kompetencat e vetqeverisjes lokale ishte i posamiratuari **Ligji për vetqeverisje lokale**² në të cilin është e theksuar qartë fuqinë e zmadhuar në disa fusha duke e paraqitur arsimin si njërin prej tyre. Për t'u akorduar me situatën e re, disa ndryshime janë bërë edhe në Ligjin për arsim fillor si dhe në Ligjin për arsim të mesëm.

Të gjitha këta ndryshime në legjislativë e kanë pas funksionin për ndryshimin e mënyrës së menaxhimit të arsimit nga ana e pushtetit qendror. Arsimi nuk ka qenë në top-listën e prioritetve të pushtetit qendror. Gjendja e dobët ekonomike në vend e ka lënë arsimin në skaj të planeve për zhvillim dhe investimet në të ishin minimale. Ripërtrirja e ndihmave për mësimdhënie dhe modernizimi me kompjuterë u realizua thuajse ekskluzivisht nga donatorë të huaj dhe nga sponsorë të tjerë. Fondet të cilat nga qendra shpenzoheshin për arsim, rrallë ishin të fokusuara për përmirësimin e arsimit, por më parë për mirëmbajtjen e gjendjes së ndërrtesave shkollore të cilat më ishte në gjendje të shkatërruar dhe për pagimin e rrogave të stafit mësimdhënës³. Sjellja e centralizuar e vendimeve lidhur me stafin, planifikimin, mbylljen dhe hapjen e shkollave, rrjetet shkollore dhe tema të tjera

¹ Pika 3 e tekstit kryesor të Marrëveshjes së Ohrit

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.05/02

³ Sindikati i arsimit të Maqedonisë "SONK" është me anëtarë më të disiplinuar dhe ka ndikim të konsiderueshëm politik dhe autoritet për negociatën me Qeverinë.

relevante të arsimit rrallë herë ishin adekuate me nevojat e bashkësisë lokale posaçërisht në rajonet e vendit të cilat janë të largëta dhe të rralla me banorë.

Më 1 Korrik 2005, në Republikën e Maqedonisë filloi procesi i decentralizimit, në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale⁴. Duke u bazuar në këtë ligj, pushtetet lokale, përveç përgjegjësive të tjera gjithashtu morrën edhe përgjegjësinë mbi arsimin. Komunitatet fitojnë pronën mbi ndërtesat shkollore, mirëmbajtjet e tyre dhe menaxhimin e transportit të nxënësve, për çka pushteti qendror do të sigurojë grante kategorike. Gjithashtu komunitatet do të jenë përgjegjëse për miratimin e dokumentave strategjike për zhvillimin dhe përmirësimin e situatës në fushën e përgjegjësive të tyre⁵, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Konstelacioni i ri juridik e siguron decentralizimin e arsimit i cili do të bëhet në dy faza. Faza e parë e decentralizimit të arsimit e cila është më e përbushur përfshin transferimin e pronës mbi ndërtesat shkollore, mirëmbajtjen e tyre dhe menaxhimin e transportimit të nxënësve për të cilën grante kategorike i siguron pushteti qendror. Faza e dytë do të përfshijë përgjegjësinë rrogat e arsimtarëve, stafit teknik dhe administrative na ana e komunës. Kjo fazë duhet të fillojë prej vitit 2007, që do të ngarkojë seriozisht buxhetin e komunës. Në këtë fazë qeveria do të sigurojë bllok grante që komunitatet t'i realizojnë kompetencat e tyre.

Me këta kompetenca të reja, vetëqeverisja lokale është bërë pjesëmarrës serioz në procesin e sjelljes së vendimeve në lidhje me arsimin. Është me rëndësi të përmendet Strategjia nacionale për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015 e cila u hartua nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës dhe e cila u miratua nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë më 18 Prill 2006. Në pjesën IV – **Pikat kryesore për intervenim**, kreu i parë - **Arsim për të gjithë**, si pikësypnim qëndron **decentralizimi i arsimit**. Në të kaluarën, përgjegjësia e shkollave, prindërve dhe bashkësive lokale për funksionim efikas si dhe mundësitë për të dizajnuar dhe implemtuar plane ka qenë e limituar nga procedurat e ndërlikuara birokratike dhe nga mundësitë e kufizuara për gjetjen e burimeve alternative financiare.

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.05/02

⁵ Neni 22, paragrafi 1 (lista e kompetencave)

3. METODOLOGJIA PËR FORMULIMIN E STRATEGJISË PËR ARSIM LOKAL NË KOMUNËN E TEARCËS

Së pari, këshilltari i PMLSHM-së gjatë periudhës të muajve qershor – korrik 2006, ka mbledhur të dhëna për vitin 2005/2006 lidhur me numrin e nxënësve, numrin e arsimtarëve, të dhënat për numrin e foshnjave të posalindura prej vitit 2000 deri në vitin 2005 dhe për transportin e nxënësve. Veç kësaj, në tetor dhe nëntor 2006, specialisti për objekte shkollore sëbashku me specialistin për financa pranë PMLSHM-së, kanë mbajtur trajnim për vlerësim të objekteve dhe për përgatitjen e planeve financiare të shkollave, ashtuqë u mbledhën të dhëna për gjendjen e shkollave dhe për buxhetin e arsimit me theks të veçant informatat plotësuese për planet financiare të shkollave⁶.

Së dyti, në Gusht të vitit 2006 u themeluar Komisioni për Arsim. Komisioni për arsim është i përbërë prej pesë anëtarëve, ku të gjithë prej tyre vijnë nga sektori i arsimit. Tri prej tyre janë këshilltarë komunal ndërsa dy të tjerët janë prej bashkësisë. Për nga arsimit dy prej tyre janë pedagogë shkollore; dy të tjerët janë arsimtarë⁷ në shkollat fillore në Tearcë ndërsa anëtari i fundit është arsimtar në shkollën e mesme profesionale të tekstilit në Tetovë. Kryetari i Këshillit Komunal, i cili njëkohësisht është edhe pedagog në shkollën fillore qendrore në Tearcë, u zgjodh kryetar i Komisionit për Arsim.

Pas pajtimit të komunës që të bën përgatitjen e strategjisë për arsimin lokal, Këshilltari për komuna i PMLSHM-së e ka përgatitur planin aksional me tendencë ta plotësojë qëllimin e Komunës së Tearcës për miratimin e Strategjisë për arsimin lokal, për shtatë vitet e ardhshme. Plani aksional përmban aktivitete, kornizë kohore dhe person përgjegjës i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e aktiviteteve konkrete.

Është merëndësi të theksohet pjesëmarrja e përgjegjësit për arsim nga komuna e Bërvenicës i cili ishte prezent në të gjitha takimet me Komisionin për arsim në Tearcë.

Më vonë, me 27 Shtator 2006 ideja për planin strategjik për arsim u prezantua para këshilltarëve komunal. U diskutua për rëndësinë e një dokumenti të tillë, procesin në tërësi, participimin e pjesëmarrësve si dhe për përfitimet prej një dokumenti të tillë.

Pas këtij takimi, më 28 Shtator 2006 pasoi takim i veçantë me Komisionin për arsim ku u prezantua procesi i krijimit të strategjisë për arsim në Tearcë duke i përfshirë rolet dhe përgjegjësitë, përmbajtjen e strategjisë si dokument, pjesëmarrësit si dhe roli i komisionit për arsim dhe roli i ekipit të PMLSHM-së. Gjithashtu u diskutua edhe vlerësimi i brendshëm si dhe hapat e ardhshme. Në këtë takim u vendos që të përfshihen këta pjesëmarrës:

- Kryetari i komunës
- Arsimtarët
- Drejtorët e shkollave
- Prindërit
- Këshilli i shkollës
- Përgjegjësi për arsim

⁶ Shiko Aneksin 1

⁷ Njëri prej këtyre arsimtarëve ka qenë këshilltar në njësinë rajonale të Ministrisë për arsim dhe shkencë

Veç kësaj u vendos të realizohen gjashtë takime të veçanta; njëri takim me drejtorët e shkollave, dhe pesë takime të tjera me anëtarët e bordeve shkollore të secilës prej pesë shkollave. Në takim u bisedua rreth pyetjeve për të cilat u vendos që të jenë pika diskutuese me pjesëmarrësit.

Më 6 Tetor 2006, u mbajt edhe një takim me Komisionin për arsim në të cilin u diskutuan pyetjet e propozuara për pjesëmarrësit, të përgatitura nga ana e PMLSHM-së, dhe në ndërkohë edhe u përfunduan pyetjet për pjesëmarrësit. U vendos që të ketë dymbëdhjetë pyetje më të rëndësishme për bordet shkollore dhe pesë pyetje për drejtorët e shkollave.

U vendos që me pjesëmarrësit të diskutohen pyetjet në vijim:

1. Çka duhet të ndërmarrin komuna ose shkollat për t'i involvuar prindërit në aktivitetet shkollore?
2. Cilat lloje të aktiviteteve të lira (pas orëve të mësimi) do të ishin më interesante për nxënësit dhe si të organizohen këta aktivitete? (p.sh. aktivitete sportive, artistike, në lidhje me lëndët shkollore)
3. Në çfarë mënyrë duhet shkolla t'ju dëshiron mirëseardhje dhe t'i integrojë nxënësit e ri (rrespektivisht klasën e parë)?
4. Çka duhet të ndërmarrin shkollat për të përmirësuar sigurinë (mbrojtjen) në shkollë (qasje kontrolluese, prezencë më e madhe e arsimtarëve në korridoret e shkollës)?
5. Si t'ju ndihmojnë shkollat nxënësve të cilët kanë probleme shkollorë (orë plotësuese, përkrahje individuale nga ana e arsimtarëve, bashkëpunim me prindërit)?
6. Në çfarë mënyrë komuna ose shkolla duhet t'i mbështesë studentët ambiciozë? (aktivitete sportive të avancuara, klube të specializuara pas shkollorë)
7. Si duhet komuna ose shkolla t'i trajtojnë ankesat e prindërve?
8. Si t'ju ndihmohet gjysëm-matuarntëve të zgjedhin shkollat e reja ose profesionin e ardhshëm?
9. Çka duhet të ndërmarrin komuna ose shkolla për të përmirësuar cilësinë e arsimit?
10. A është i nevojshëm ushqimi i ngotë në shkollë dhe si mund të organizohet?
11. Çka duhet të bëjnë prindërit për shkollën?
12. Cili duhet të jetë roli i këshillit të shkollës?

Pyetje plotësuese për takimet me drejtorët e shkollave:

1. Si të përmirësohet motivimi i arsimtarëve? (bonuse, çmime, mirënjohje)
2. Çfarë përgatitje/aftësi plotësuese ju nevojiten arsimtarëve?
3. Si duhet komuna t'i promovojë/vlerësojë drejtorët e shkollave?
4. Si të përmirësohet rrespekti ndaj arsimtarëve?
5. Cila duhet të jetë pozita e shkollave periferike?
6. Çfarë funksioni tjetër duhet luajë shkolla?
7. Si dëshironi të punoni me shkollat periferike? (Në kuptim të vlerësimit të punës së shkollës periferike, shpërndarjen e mjeteve, vlerësimin e arsimtarëve, etj)

Gjatë ditëve 25, 26, 27, 30, 31 Tetor dhe 1 Nëntor 2006, janë organizuar gjashtë takime, një me drejtorët e shkollave dhe pesë me këshillat e shkollave të pesë shkollave fillore qendrore. Në këshillat e shkollave kishte përfaqësues të arsimtarëve, prindërve dhe pedagogëve të shkollave.

Takimet u organizuan në mënyrë të tillë që prej komunave kanë marrë pjesë Kryetari i komisionit për arsim, Përgjegjësi për arsim dhe një anëtar i komisionit i cili jeton në vendbanimin ku duhet të mbahet takimi. Në emër të PMLSHM-së ishte Këshilltari për komuna. Të gjitha takimet ishin të udhëhequra nga ana e Kryetarit të komisionit dhe ishin të përkrahura prej Këshilltarit për arsim dhe prej Përgjegjësit për arsim, ndërsa ishin të ndara në dy pjesë. Pjesa e parë ishte prezantim i përgjithshëm dhe pjesa e dytë diskutim i pyetjeve.

Përndryshe, skenari i takimeve ishte si në vijim:

- Piksëpari Kryetari i komisionit para pjesëmarrësve e bëri prezantimin, qëllimet e takimit dhe ka dhënë skicë të përgjithshme të projektit,
- U bë prezantimi i pjesëmarrësve,
- Këshilltari për komuna e prezantoi në përgjithësi projektin e PMLSHM-së, nën-projektin në Tearcë si dhe atë se çka do të ndërmerret,
- Përgjegjësi për arsim shpjegoi pjesëmarrësve angazhimin e komunës në këtë projekt,
- Kryetari i ka pyetur pjesëmarrësit a kanë nevojë për shpjegim plotësues, ose mos është diçka e paqartë në lidhje me projektin.

Pas pjesës së parë të takimit kryetari hapi diskutim rreth pyetjeve. Procedura rrjedhte në atë mënyrë që secila pyetje u lexua nga ana e kryetarit dhe shpjegimet plotësuese u dhanë nga ana e Këshilltarit për komuna.

Në të gjitha takimet Kryetari i komisionit, Përgjegjësi për arsim dhe Këshilltari për komuna kanë marrë shënime për secilën pyetje në veçanti. Në fund të këtij maratoni Këshilltari për komuna i ka marrë përmbledhjet e shënimeve prej Përgjegjësit për arsim dhe ka përgatitur dy përmbledhje dokumentesh; një për takimin me drejtorët e shkollave dhe një për takimet me të gjithë këshillat e shkollave.

Takimi i parë u mbajt më 25 tetor 2006, me të gjithë drejtorët e shkollave. Prej këtyre takimeve u ngritën disa probleme si dhe u dhanë disa propozime për zhvillimin e ardhshëm lidhur me arsimin në Tearcë. Këta janë çështjet më të rëndësishme të cilat u shtruan nga ana e pjesëmarrësve, dhe çështje të cilat sipas drejtorëve të shkollave duhet të zgjidhen me anë të strategjisë afatgjate për arsim:

Drejtorët shkollorë:

- Ciësia e arsimit
- Zhvillim profesional i stafit mësimdhënës; trajnim për informatikë, gjuhë të huaja
- Rrogat e stafit mësimdhënës
- Involvimi i shkollave periferike në procesin e sjelljes së vendimeve
- Trajtimi i shkollave periferike nga ana e drejtorëve të shkollave; punë ekipore; vizita të rregullta
- Vetë-vlerësimi i shkollave

Më 25, 26, 27, 30, 31 Tetor dhe më 1 Nëntor 2006, siç u përmend më lartë u mbajtën pesë takime të veçanta me pesë bordet e shkollave. Viojnë përmbledhjet prej secilit pjesëmarrës:

Prindërit:

- Bashkëpunim në mes të këshillit të shkollës dhe këshillit të prindërve,
- Involvimi i prindërve në aktivitetet shkollore,
- Involvimi i këshillit të prindërve në përpilimin e planprogramit vjetor,
- Bashkëpunim në mes të organeve shkollore dhe prindërve,
- Përmirësimi i sigurisë së nxënësve duke instaluar lloje të ndryshme të pajisjeve teknologjike dhe procedurave të sigurimit,
- Hapja e klasës të posaçme për nxënësit e hendikepuar.

Arsimtarët:

- Zhvillim profesional,
- Rroga më të mira, kushte më të mira për punë,
- Pajisja e shkollave me mjete ndihmëse për mësim,
- Promovimi i nxënësve më të mirë.

Këshilli i shkollës:

- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore,
- Inicimi i projekteve në lidhje me aktivitetet shkollore dhe përmirësimi i kushteve shkollore,
- Bashkëpunim më i ngushtë me organe tjera shkollore,
- Krijimi i metodave efikase për menaxhimin e shkollave.

Duke u bazuar në takimet paraprake me Kryetarin e komunës të Tearcës, dhe duke u nisur prej asaj se Kryetari i komunës të Tearcës është njëri prej pjesëmarrësve, çështjet e ngritura prej tij, të cilat duhet të zgjidhen me anë të strategjisë lokale për arsim janë:

- Optimizimi i rrjetit shkollor,
- Hapja e arsimit të mesëm bashkëkohor,
- Përmirësimi i kualitetit të arsimit,
- Përmirësimi i gjendjeve të objekteve shkollore.
- Përmirësimi i menaxhimit të shkollave
- Planifikon zhvillimin e shkollimit fillor dhe të mesëm
- Bën alokimin e fondeve të domosdoshme, duke i përfshirë këtu edhe subvencionet për arsim
- Menaxhojë në mënyrë efektive me shkollat dhe me rrjetin shkollor
- Parashikojë ndryshimet demografike
- Lejojë të gjithë pjesëmarrësit, posaçërisht drejtorët e shkollave, t'i përshtatin aktivitetet e tyre profesionale sipas pritjeve dhe planeve të themeluesit të shkollës
- Analizojë tregun e punës dhe zhvillimin lokal ekonomik

Pas këtyre takimeve Këshilltari për komuna dhe Konsultanti i programit i kanë shqyrtuar të gjitha shënimet prej këtyre takimeve dhe përgatitën dhe i propozuan qëllimin strategjik dhe pikësynimet strategjike të cilat do të jenë pjesë e dokumentit strategjik. Gjithashtu, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë muajve të kaluar në lidhje me nxënësit, foshnjat e posalindura, arsimtarët, buxhetin, transportin dhe vlerësimin teknik të shkollave, u përgatitën disa shembuj të SWOT analizës, e cila do të jetë pjesë e SWOT analizës për Tearcën.

Më 16 Nëntor 2006, u organizua takim me Kryetarin e komunës së Tearcës. U prezantua përpilimi i parë i qëllimit strategjik dhe të pikësynimeve strategjike si dhe shembuj të SWOT analizës. Gjithashtu më 17 Nëntor u organizua një takim tjetër me Komisionin për arsim në të cilin u prezantua propozimi i parë i qëllimit dhe pikësynimeve strategjike. Gjatë takimit me Komisionin për arsim u riformuluan qëllimi dhe pikësynimet e propozuara strategjike.

Pasiqë ekipi i PMLSHM-së dhe Komisioni për arsim e definuan qëllimin strategjik dhe pikësynimet strategjike, Këshilltari për komuna filloi me përgatitjen e draft aktiviteteve të para për çdo pikësynim. Për t'i realizuar pikësynimet strategjike, është esenciale të përgatiten aktivitete. U dha propozim që pikësynimet strategjike të ndahen në pikësynime punuese (operative) dhe për çdo pikësynim punues të ketë disa aktivitete. Aktivitetet u zhvilluan në mënyrë që çdonjëri prej tyre të ketë kornizë kohore, kur do të fillojë, kur do të mbarojë, resurset e nevojshme dhe person përgjegjës i cili do ta kryejë aktivitetin e duhur.

Për këtë shkak menaxheri i programit të PMLSHM-së dhe Këshilltari komunal më 30 Nëntor 2006 mbajtën takim me Komisionin për arsim në të cilin e bënë prezantimin e draft aktiviteteve të para. Secilit anëtar të komisionit ju dha nga një kopje e këtyre draft aktiviteteve të para.

Ekipi i PMLSHM-së e zhvilloi draft raportin e parë të SWOT analizës për strategjinë lokale për arsim, dhe të njëjtin më 8 Dhjetor 2006 e prezantoi para Komisionit për arsim dhe drejtorëve të shkollave si dhe para Specjalistit për arsim prej Komunës së Bërvenicës. Të gjithë pjesëmarrësit fituan nga një kopje të SWOT raportit. Takimi ishte i strukturuar në mënyrë që Këshilltari për komuna bëri pauerpoint (PowerPoint) prezantim në të cilin kanë qenë të përmbledhura pikat më të rëndësishme të SWOT raportit. Pas mbarimit të prezantimit, pjesëmarrësit e kishin mundësinë që të parashtronë pyetje në lidhje me prezantimin. Pyetjeve të parashtruara ju përgjigjeshin Këshilltari komunal, Menaxheri i Programit të PMLSHM-së si dhe Përgjegjësi për arsim prej Tearcës.

Në sesionin e dytë të takimit u diskutua rreth SWOT analizave. Çdonjëri prej pjesëmarrësve fitoi nga një blanko kopje të SWOT formatit. Nga ana tjetër Përgjegjësi për arsim e lehtësonte diskutimin në lidhje me Forcat (përparsitë), Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet. Diskutimi u menaxhua në mënyrë që Specjalisti për arsim në një tabelë (flip chart) i ka vendos të gjitha idetë e pjesëmarrësve dhe pas kësaj i ka strukturuar sipas rradhitjes përkatëse, respektivisht sipas kategorisë të cilës i takojnë.

Në fund lehtësuesi e bëri përmbledhjen e SWOT tabelën dhe të gjithë pjesëmarrësit u dakorduan rreth SWOT analizës.

SWOT analiza u bazua në raportet dhe të dhënat për secilën shkollë, për secilin nxënës, arsimtarë, të dhënat për buxhetin, vlerësimi teknik, planet financiare, demografike si dhe në të dhëna të tjera të fituara prej komunës.

3.1 Informata të përgjithshme

Komuna e Tearcës është komunë rurale me popullatë prej 22.454 banorësh të nacionaliteteve të ndryshme, si shqiptarë, maqedonas, turq, romë, serbë etj. Shqiptarë janë 18.950 ose 84,39%; maqedonas 2.739 ose 12,20%; turq 512 ose 2,29%; romë 54 ose 0,24%; serbë 7 ose 0,03% dhe të tjerë 167 ose 0,74%. Struktura e moshës në komunë është: moshë prej 0 deri 14 vjet 5.453 banorë; prej 15 deri 64 vjet 15.005 banorë; mbi 65 vjet 1.959 banorë, dhe banorë me moshë të panjohur janë gjithsej 37.


Gjithashtu, në lidhje me nivelin e arsimit janë: 489 me fakultet të mbaruar, 245 me shkollë të lartë të mbaruar (më pak se ata të cilat kanë mbaruar fakultet) dhe 3.342 me shkollë të mesme të mbaruar; 10.071 banorë janë me shkollë fillore të mbaruar, 1.885 nuk e kanë mbaruar shkollën fillore dhe 933 banorë janë analfabet. Është me rëndësi të përmendet se dhjetë persona janë magjistra ndërsa pesë persona janë me titull “doktor i shkencës”. 416 banorë të gjinisë femrore janë të punësuar, ndërsa 887 janë të papunësuar; 1.409 banorë të gjinisë mashkullore janë të punësuar, ndërsa 2.128 janë të papunësuar.

Duke e marrë parasysh procesin e decentralizimit si dhe problemet në arsim, komuna ka caktuar Përgjegjës për arsim i cili do ta zbatojë arsimin në Tearcë. Zyrtari komunal i caktuar për të kryer detyrat lidhur me arsimin ka qenë arsimtar në shkollën fillore në Tearcë. Ai ka mbaruar fakultetin pedagogjik. Kjo do të thotë se Përgjegjësi për arsim është mirë i informuar për problemet në sektorin e arsimit dhe posedon dituri solide për kryerjen e detyrave për të cilat është i caktuar. Në kuadër të Këshillit komunal funksionon Komisioni për Arsim, i cili merret kryesisht me çështjet e arsimit. Komuna e Tearcës në një të ardhme të afërt planifikon të punësojë edhe një nëpunës publik i cili do të punonte në sferën e arsimit. Në perspektivë afatgjate komuna ka si qëllim të emëroj inspektor komunal për arsim.

Në kuadër të komunës së Tearcës funksionon sektori për Zhvillim lokal ekonomik. Brenda këtij sektori janë përgatitur disa dokumente për zhvillim ekonomik, ku arsimi ka qenë i inkorporuar në aktivitetet dhe prioritetet e përgjithshme për zhvillim në të ardhmen.

4. SITUATA E ARSIMIT NË TEARCË

4.1 Numri i shkollave dhe gjendja e tyre



Komuna e Tearcës i ka 5 shkolla fillore qendrore dhe 3 periferike. Shkollat fillore qendrore janë: “Eqrem Çabej” e cila ndodhet në fshatin Sllatinë, “Kiril Pejçinoviç” e cila ndodhet në fshatin Tearcë, “Asdreni” e cila ndodhet në fshatin Gllogjë, “Faik Konica” e cila ndodhet në fshatin Dobrosht dhe “Ismail Qemali” e cila ndodhet në fshatin Nerashke.

Tri shkollat periferike janë: “Eqrem Çabej” që ndodhet në fshatin Neproshten, dhe i takon shkollës fillore qendrore “Eqrem Cabej” nga fshati Sllatinë; “Kiril Pejçinoviç” që ndodhet në fshatin Leshkë dhe i takon shkollës fillore qendrore “Kiril Pejçinovic” nga fshati Tearcë dhe “Faik Konica” që ndodhet në fshatin Odër dhe i takon shkollës fillore “Faik Konica” nga fshati Dobroshtë.

Në Komunën e Tearcës nuk ka shkollë të mesme. Nxënësit të cilët e mbarojnë shkollën fillore, shkollimin e mesëm e ndjekin në shkollat e mesme të Komunës së Tetovës.

Objektet shkollore janë ndërtuar në periudhën e viteve 1933 deri në vitin 19 dhe deri në vitin 1974 disa shkolla janë renovuar dhe janë shtuar, duke u bazuar në nevojat dhe mundësitë. Në periudhën prej viteve 1974 deri në vitin 2000, ndaras nga mirëmbajtja e përditshme nuk janë ndërmarrë aktivitete të mëdha për riparim.

Në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2006 ka pasur disa riparime të mëdha në objektet shkollore në Komunën e Tearcës, duke përfshirë: Riparimin e tre shkollave qendrore në vendbanimet Tearcë, Sllatinë dhe Gllogje; Riparimi i shkollës periferike në vendbanimin Neproshten; Është ndërtura shkolla e re periferike në Odër, duke e përfshirë edhe instalimin e nxemjes qendrore; Instalimin e nxemjes qendrore në shkolla qendrore në Tearcë, Dobroshtë dhe Sllatinë. Shkolla qendrore në Nerashkë dhe shkolla periferike në Leshkë nuk kanë pasur asnjë riparim që nga koha kur janë ndërtuar, dhe për këtë këto shkolla janë në gjendje të keqe, përveç dritareve në shkollën fillore në Nerashkë.

Shkolla fillore qendrore “Eqrem Çabej”- Sllatinë

Shkolla qendrore “Eqrem Çabej” në fshatin Sllatinë është ndërtuar në vitin 1974. Objekti ka bodrum dhe dy katë dhe është në gjendje të mirë. Infrastruktura përfshin ujësjellës, system të kanalizimit dhe system elektrik në pajtueshmëri me normat dhe standardet përkatëse. Shkolla ka vendosur dritare të reja në vitin 2006 si dhe system të nxemjes qendrore. Toaletet janë në gjendje jo të mirë dhe ju nevojitet rindërtim urgjent.

Shkolla periferike “Eqrem Çabej” - Neproshten

Shkolla periferike “Eqrem Çabej” – Neproshten është ndërtuar në vitin 1954. Objekti ka vetëm një kat dhe është në gjendje të mirë. Rindërtim i të gjitha instalacioneve u bë në vitin 2006 për të qenë në pajtueshmëri me normat dhe standardet përkatëse. Objekti nxehet me furra më dru. Toaletet janë në gjendje jot ë mirë.

Shkolla fillore qendrore “Kiril Pejçinoviç” - Tearcë

Shkolla qendrore “Kiril Pejçinoviç” në Teracë i ka dy objekte, të cilat janë në gjendje të mirë. Objekti i parë është ndërtuar në vitin 1933 dhe deri në vitin 1988 ka shërbyer si shkollë e mesme. Objekti është në dy kat; nuk ka ujësjellës dhe system të kanalizimit, ndërsa sistemi elektrik është në gjendje jo të mirë. Ky objekt nuk është rindërtuar asnjëherë. Nxemja bëhet më furra me dru. Objekti tjetër është ngritur në vitin 1948 dhe është në gjendje të mirë. Ka bodrum dhe dy kate, me tërë infrastrukturën e nevojshme: ujësjellës, instalim të kanalizimit dhe instalim elektrik sipas standardeve. Shkolla është renovuar në vitin 1999 dhe ka nxemje qendrore.

Shkolla periferike “Kiril Pejçinoviç” – Leshkë

Shkolla periferike “Kiril Pejçinoviç” në Leshkë u ndërtua në vitin 1933. Objekti është në dy kat. Konstruksioni i objektit është i mirë, por sidoqoftë për shkak të mirëmbajtjes së dobët është në gjenje shumë të keqe. Nuk ka ujësjellës dhe system të kanalizimit, ndërsa sistemi elektrik nuk është në pajtueshmëri me standardet përkatëse. Karpenteria në object është tërësisht e vjetëruar; dyshemetë janë jot ë mira; ndërsa objekti nxehet me furra me dru. Nuk ka toalete në ndërtesën shkollore.

Rindërtim i tërësishëm është i domosdoshëm. Por duke e marrë parasush numrin e nxënësve të cilët e ndjekin këtë shkollë (11 nxënës) si dhe trendin demografik në këtë periudhë (rënia e numrit të nxënësve) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër shpenzimet për rindërtim në kokë të nxenesit, siduket rindërtimi nuk është i arsyeshëm.

Shkolla fillore “Asdreni” - Glllogjië

Shkolla qendrore “Asdreni” në Glllogjië u ndërtua në vitin 1933, dhe u zgjërua në vitin 1981. Objekti është ndërtesë në dy kat dhe ka bodrum, ndërsa të dy pjesët e objektit si e vjetra ashtu edhe e reja janë në gjendje të mirë. Infrastruktura, ujësjelësi, sistemi i kanalizimit si dhe instalimi elektrik i përmbushin standardet, por toaletet janë në gjendje jo të mirë. Objekti u rindërtua në vitin 1996. Nxemja është me furrë me dru.

Shkolla fillore qendrore “Faik Konica” – Dobroshtë

Shkolla fillore qendrore “Faik Konica” në Dobroshtë i ka tri ndërtesa. Ndërtesa e parë u ndërtua në vitin 1933, e dyta në vitin 1966 dhe e treta në vitin 2002. E para ka vetëm një kat, pa ujësjellës dhe system të kanalizimit, ndërsa gjendja eletriike nuk është e mirë. Karpenteria është e vjetëruar, dyshemetë janë në gjendje jo të mirë dhe objekti nxehet me furrë më dru. Ndërtesa e dytë ka bodrum dhe dy kate. Karpenteria nuk është në gjendje shumë të mirë. Shkolla ka nxemje qendrore, ndërsa toaletet janë në gjendje jot ë mirë. Objekti i ndërtuar para disa viteve është në gjendje të mirë, duke e pasur tërë infrastrukturën në vend.

Shkolla periferike “Faik Konica” – Odri

Shkolla periferike “Faik Konica” në Odri u ndërtua në vitin 2001. Ndërtesa dykatëshe me bodrum është në gjendje të mirë. Ka ujësjellës dhe instalim elektrik, por i mungon sistemi i kanalizimit. Shkolla përdor cisternë septike. Nxemja qendrore është e instaluar.

Shkolla fillore qendrore “Ismail Qemali” - Nerashtë

Shkolla qendrore “Ismail Qemali” në Nerashtë daton që nga viti 1948, ndërsa rindërtimi i fundit u bë në vitin 1968. Objekti është në gjendje jo të mirë. Ujësjellësi, cisterna septike dhe instalimi elektrik janë në gjendje jo të mirë. Objekti nxehet me furre me dru dhe dyert janë në gjendje jo të mirë. Toaletet gjithashtu janë të shkatërruara dhe i mungojnë standardet e duhura.


Komisionin për Arsim dhe drejtorët e shkollave, duke u bazuar në të dhënat për objektet shkollore të cilat u grumbulluan nga specialisti për vlerësimin e objekteve shkollore i PMLSH, gjithashtu duke u bazuar edhe në dhe kërkesat e drejtorëve të shkollave për projektet investuese prioritare, dhe metodologjinë për rangimin e prioriteteve e cila u përdorë në Komunën e Strumicës, përpiluan rang listën e projekteve prioritare për investime në shkolla.

Shkolla fillore	Projekti	Rangimi i projekteve	Çmimi MKD
Sh.F. "Ismal Qemali" Nerasht	1. Nxemja qendrore	5	2,300,000
	2. Ndërrimi i dritareve	Janë të rregulluar	
	3. Ndërrimi i dysHEMEVE (pa sallën dhe tualetet)	11	950,000
Sh.F "Faik Konica" Dobrosht	1. Ndërrimi i dritareve dhe dysHEMEVE	3	750,000
	2. Suvatimi i mureve të objektit	12	300,000
	3. Ndërrimi i pllakave të dysHEMEVE	10	520,000
Sh.Periferike "Faik Konica" Odri	1. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike	15	10,000,000
	2. Biblioteka e shkollës	17	
	3. Blerja e mjeteve mësimore	18	
Sh.F. "Asdreni" Gllgjë	1. Nxemja qendrore	6	3,600,000
	2. Ndërrimi i dritareve	4	800,000
Sh.F. "Kiril Pejçinoviç" Tearcë	1. Nxemja qendrore (objekti i vjetër)	8	1,700,000
	2. Ndërrimi i konstruksionit dru - beton (për dy katet)	9	1,200,000
	3. Rregullimi i dysHEMEVE	9	480,000
Sh.F. "Eqrem Çabej" Sllatinë	1. Ndërtimi i nyjes sanitare	1	751,150
	2. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike	14	11,000,000
	3. Lyerja e jashtme e shkollës - fasada	13	1,000,000
Sh. Periferike "Eqrem Çabej" Neproshten	1. Ndërrimi i nyjeve sanitare	2	400,000
	2. Vendosja e nxemjes qendrore	7	2,500,000
	3. Asfaltimi i fushës sportive	16	1,500,000
TOTAL			39,751,150

4.2 Rrjeti shkollor dhe karakteristikat e mësimdhënësve

4.2.1 Rrjeti shkollor

Numri i përgjithshëm i nxënësve për çdo shkollë në vitin shkollor 2005/2006



Shkolla fillore qendrore "Eqrem Çabej"- Sllatinë

Shkolla fillore qendrore "Eqrem Çabej" ndodhet në fshatin Sllatinë. Mundëson arsim fillor prej klasës 0 deri në klasën e 8^{të} në gjuhën shqipe. Shkolla përfshin nxënësit e fshatit Sllatinë. Nuk ka klasë të kombinuara në këtë shkollë. Numri i përgjithshëm i klasëve të pakombinuara prej klasës 0 deri në klasën e 8- të është 24 klasë. Shkolla punon në dy ndërrime. Ndërrimi i parë fillon prej në mëngjes ndërsa i dyti pasdite.

Rajoni shkollor i shkollës fillore qendrore "Eqrem Çabej" në Sllatinë dhe shkollës periferike në Neproshten i përfshin fshatrat Sllatinë dhe Neproshten.


2005/2006

Klasa	Nr i klasëve të pakombinuara	Nr i nxënësve	Nr i klasëve të ndërrimit të pasdites	Nr i klasëve të ndërrimit të mëngjesit	Djem	Vajza
0	2	42	2	0	23	19
I	2	43	2	0	27	16
II	2	52	2	0		
III	3	69	3	0	43	26
IV	3	69	3	0	35	34
V	3	70	0	3	41	29
VI	3	76	0	3	35	41
VII	3	70	0	3	45	25
VIII	3	69	0	3	35	34
Gjithsej	24	560	12	12	284	224

Indikatorë:

- Nxënës për gjeneratë (klasa 0-8) = 23, 3
- Nxënës për klasë = 43
- Nxënës në klasa për ndërrim = 21,5
- Nxënës në klasë të kombinuara = 0
- Ndërrimi i dytë 313

Të dhënat demografike për foshnjat e posalindura prej vitit 2000 deri në vitin 2005 për fshatin Sllatinë janë marrë prej njësisë lokale shëndetsore në fshatin Tearcë. Projektimet e bazuara në të dhënat për foshnjat e lindura dhe të dhënat për nxënësit e regjistruar në vitin 2005/2006, tregojnë se në vitet e ardhshme numri i nxënësve do të zvogëlohet. Në përgjithësi trendi demografik është i qëndrueshëm.



Ndryshimet demografike në shkollën fillore “Eqrem Cabej”-numri i nxënësve

2005/2006	2006/2007	2007/2008	2008/2009	2009/2010	2010/2011
560	535	500	467	443	421

Shkolla periferike “Eqrem Çabej” - Neproshten

Shkolla periferike në Neproshten i përfshin nxënësit e fshatit Neproshten. Mundëson shkollim fillor në gjuhën shqipe prej klasës 0 deri në klasën e 8^{te}. Mundëson shkollim fillor në gjuhën maqedonase prej klasës së 1^{te} deri në klasë të 4^{te}. Nxënësit maqedonas klasët e larta (prej 5 deri në 8) i ndjekin në shkollën fillore qendrore “Kiril Pjeçinoviç” në Tearcë. Shkolla gjithashtu mundëson shkollim për vitin përgatitës parashkollor në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Në shkollën periferike në Neproshten është një klasë e kombinuar e cila përbëhet prej nxënësve maqedonas prej klasave I, II, III, IV. Numri i përgjithshëm e klasave të pakombinuara është 10 klasë. Shkolla punon në dy ndërrime. Ndërrimi i parë është prej në mëngjes ndërsa i dyti prej pasdite.


2005/2006

Klasa	Nr i klasëve të pakombinuara	Numri i klasave të kombinuara	Nr i nxënësve	Nr i klasëve të ndërrimit të pasdites	Nr i klasëve të ndërrimit të mëngjesit	Numri i nxënësve në klasa të kombinuara	Djem	Vajza
0	2	0	31	2	0	0	18	13
I	1	1	10	1	0	10	4	6
II	1	0	10	1	0	0		
III	1	0	12	1	0	0	8	4
IV	1	0	18	1	0	0	12	6
V	1	0	16	0	1	0	4	12
VI	1	0	18	0	1	0	8	10
VII	1	0	18	0	1	0	8	10
VIII	1	0	18	0	1	0	10	8
Total	10	1	151	6	4	10	72	69

Indikarorë:

- Nxënës për gjeneratë (klasa 0-8) =13
- Nxënës për klasë =30
- Nxënës në klasë për ndërrim =15
- Nxënës në klasë të kombinuara =10
- Ndërrimi i dytë =70

Të dhënat demografike për foshnjat e posalindura prej vitit 2000 deri në vitin 2005 për fshatin Neproshten janë marrë prej njësisë lokale shëndetsorë në fshatin Tearcë. Projektimet e bazuara në të dhënat për foshnjat e lindura dhe të dhënat për nxënësit e regjistruar në vitin 2005/2006, tregojnë se në vitin 2009, 2010 dhe 2011 numri i nxënësve të klasës së tetë do të zvoglohet shpejt. Do të ketë luhatje në numrin e nxënësve të klasës së katërt në vitet e ardhëshme. Në përgjithësi trendi demografik do të zvogëlohet, por shkolla do të vazhdojë të funksionoj normalisht.



Ndryshimet demografike në shkollën fillore “Eqrem Cabej”-numri i nxënësve

2005/2006	2006/2007	2007/2008	2008/2009	2009/2010	2010/2011
151	143	136	131	129	125

Shkolla fillore qendrore “Kiril Pejçinoviç” - Tearcë

Shkolla fillore qendrore “Kiril Pejçinoviç” ndodhet në fshatin Tearcë. Mundëson shkollim fillor në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke prej klasës 0 deri në klasën e 8^{të}. Shkolla i përfshin nxënësit prej fshatit Tearcë. Shkolla qendrore gjithashtu i pranon nxënësit maqedon prej fshatrave Leshkë, Neproshten, Dobroshtë dhe Glllogji të cilët ndjekin mësimin prej klasëve V – VIII në Tearcë. Numri i përgjithshëm i klasëve të pakombinuara është 2 klasë dhe ata janë klasa turke. Shkolla punon në dy ndërrime. Ndërrimi i parë fillon prej në mëngjes ndërsa i dyti pasdite.

Janë: 17 klasa shqiptare, 9 klasa maqedonase dhe 7 klasa turke (5 të pakombinuara dhe 2 të kombinuara).

Rajoni shkollor i shkollës fillore qendrore “Kiril Pejçinoviç” në Tearcë dhe i shkollës periferike në Leshkë i përfshin fshatrat Tearcë, Leshkë, Neproshten, Dobroshtë dhe Glllogji.


2005/2006

Klasa	Nr i klasëve të pakombinuara	Numri i klasave të kombinuara	Nr i nxënësve	Nr i klasëve të ndërrimit të pasdites	Nr i klasëve të ndërrimit të mengjesit	Numri i nxënësve në klasa të kombinuara	Djem	Vajza
0	3	0	31	3	0	0	18	13
I	3	1	45	4	0	11	22	23
II	3	1	46	4	0	8	21	25
III	3	0	41	3	0	0	21	20
IV	3	0	53	3	0	0	29	24
V	4	0	64	0	4	0	34	30
VI	4	0	75	0	4	0	41	34
VII	4	0	66	0	4	0	36	30
VIII	4	0	76	0	4	0	39	37
Total	31	2	497	17	16	19	261	236

Indikarorë:

- Nxënës për gjeneratë (klasa 0-8) =15
